

Tregojnë skica të hershme të Kristos në qytetin Varna



КРИСТО – РАННИ ЕТЮДИ

Piktura mësimore dhe piktura me bojëra uji të piktorit me famë botërore me prejardhje bullgare Kristo janë të ekspozuara në Galerinë Artistike të Qytetit në Varna. Krijimet janë nga koha kur Hristo Javashv ka mësuar në Akademinë Kombëtare Artistike. Në ekspozitën “Kristo – etyde të hershme” mund të shikohen po kështu postera me autografet e Kristos dhe të bashkëshortes së tij Zhan-Klod, të cilët dokumentojnë disa nga paketimet emblematike të godinave. Në galeri janë paraqitur dhe kopje të dy portreteve nga vitet studentore të krijuesit – të artistes Graciella Bëçvarova nga viti 1954 dhe të piktores Dora Boneva nga viti 1956, si dhe një material të pasur dokumentar për Kriston dhe për historinë e tij fisnore, për truallin fisnor, fotografi të familjes. Ekspozita me eksponate nga përmbledhja e muzeut të Akademisë Kombëtare Artistike do të mbetet në kryeqytetin detar deri më 25 gusht.